

| | |
|--|---|
| REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO | |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY | |
| Dena: Dupa: Nr. Prot. Broj. shënime: Nr. pages | Nr. Prot. Br. Prot. Prot. Nr. Dena: Emri: Dat. |
| AKK/DDP | 03/4431/12 |
| | 14.12.12 |

GJL. Nr.1173/2012

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Dalip Bega dhe Ragip Namani anëtarë, me pjesëmarrjen e sek. Juridike Sanije Salihu, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga Agjencioni Kundër Korrupsionit-Prishtinë, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prizren, Regj.I.nr.12790/2011 të dt. 22.06.2012, në bazë të nenit 31, al.3,39 dhe 222 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 29.10.2012, mori

A K T V E N D I M

Ankesa e paraqitur është e **BAZUAR**

ABROGOHET aktvendimi i goditur dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në plotësim të procedurës dhe rivendosje.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

A r s y e t i m

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prizren, me aktvendimin Regj.I.nr.12790/2011 të dt. 22.06.2012, ka shpallë përgjegjës të pandehurin Qazim Gashi nga Prizreni, sepse si zyrtarë e lartë publik-drejtor i Departamentit të Administratës të Spitalit Regjional të Prizren, nuk e ka bërë deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë për vitin 2010 nga paragrafi 1 të nenit 5 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen, Kontrollin e Pasurisë, dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, me ç'veprim ka kryer kundërvajtje nga neni 6 par.1 të ndëshkuar sipas nenit 16 par.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të zyrtarëve të Lartë Publik me nr.03/L-151, e me aplikimin e nenit 10 të Ligjit mbi kundërvajtjet, të pandehurës i është shqiptuar dënimi me Qortim.

Kundër këtij aktvendimi Agjencioni Kundër Korrupsionit në Prishtinë, ka paraqitur ankesë, për shkak të: shkeljeve të Ligjit mbi kundërvajtje dhe vendimit mbi dënimin, ashtu siç rrjedh nga përmbajtja e ankesës. Thekson se i pandehuri për shkak të mos deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë ka kryer kundërvajtje nga neni 6 e ndëshkuar sipas nenit 16 par.1.1 të Ligjit nr.03/L-151 dhe se gjykata nuk i ka shqiptuar dënim meritor në pajtim me Ligjin, se deklarimi i pasurisë është përgjegjësi e lartë publike dhe zbutja e dënimit në një masë të madhe bie në kundërshtim me rregullat për zbutjen e dënimit, andaj ka propozuar që aktvendimi i goditur të abrogohet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe të njëjtës ti shqiptohet dënim meritor në pajtim me Ligjin.

Kolegji i kësaj gjykate vlerësoi ankesën e paraqitur, aktvendimin e goditur, deklarimin e dhënë të pandehurit në seancën e shqyrtimit kryesor pranë gjykatës së shkallës së parë në procesverbal të dt. 27.09.2011, i cili nuk e ka pranuar kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, deklarimin e dëshmitarit Afrim Atashi përfaqësuesi i AKK-së, deklarimin e dëshmitarit Muzafer Kalenderi, si dhe shkresat e tjera të lëndës, andaj ka gjetur se:

Ankesa e paraqitur është e bazuar.

Duke vendosur për ankesën dhe duke vlerësuar aktvendimin mbi dënimin dhe pretendimet ankimore se dënimi me Qortim është i butë dhe në kundërshtim me rregullat për zbutjen e dënimit, Kolegji vlerëson se lidhur me këtë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe drejtë, se a janë përmbushur kushtet ligjore për shqiptimin e dënimit Qortim.

2.

Meqë nga shkresat e lëndës përkatësisht nga procesverbali i marrjes në pyetje shifet se është zyrtar i lartë publike dhe ka deklaruar gjendjen e mesme ekonomike, dhe ka bërë deklarin e pasurisë pas disa muajve pas inicimit të procedurës kundërvajtëse dhe siç shifet nuk është vlerësuar shkalla e përgjegjësisë se vepra është kryer me dashje apo nga pakujdesia, që janë nga arsyerat themelore që duhet vlerësuar me rastin e vendosjes për shqiptimin e dënimit. Andaj pretendimi ankimor se në rastin konkret nuk janë vlerësuar dejtë dhe në mënyrë të plotë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, është i bazuar.

Pastaj me shiqimin e shkresave të lëndës sipas detyrës zyrtare konstatohet se i pandehuri e ka mohuar ta ketë kryer kundërvajtjen, me arsyetim se nuk është njoftuar lidhur me deklarin e pasurisë. Kurse nga deklaratat e dëshmitarëve dhe njoftimi i Ministrisë së Shëndetësisë nuk mund të kuptohet kjo se kur e kanë njoftuar të pandehurin për obligimin e saj për deklarin e pasurisë, se nuk është ofruar si dëshmi lista për pranimin e dokumentacionit. Prandaj në këtë çështje kundërvajtëse gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe drejtë, dhe se në shkresat e lëndës nuk ka prova për aplikimin e nenit 10 të Ligjit për kundërvajtje me rastin e zbutjes së dënimit të pandehurës. Andaj për këto arsye Kolegji vlerëson se aktvendimi i goditur nuk mund të qëndroi dhe është abroguar që në plotësim të procedurës gjykata e shkallës së parë duhet të veproi sipas vërejtjeve të theksuara më lartë, të konstatoi dhe dëshmoi se është njoftuar apo jo i pandehuri për obligimin e deklarimit të pasurisë sipas mënyrës së paraparë me Ligj. Sipas nevojës të administrohen edhe prova të tjera e pastaj pas vlerësimit të gjitha rrethanave dhe vërtetimit të gjendjes faktike të nxjerrë aktvendim të ri duke pas për bazë edhe thëniet e paraqitura në ankesën e organit kompetent Agjencionit Kundër Korrupsionit, e pastaj të vendos lidhur me këtë çështje kundërvajtëse.


Më sa u tha më lartë konform nenit 222 të Ligjit mbi kundërvajtjet u vendos si në dispozitiv.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

GJL. Nr. 1173/2012 të dt. 29.10.2012.

SEK. JURIDIKE
Sanije Salihu



KRYETARI I KOLEGJIT,
Ramiz Kuqi